

## AKT-THEMELIMI

### **“Sallaku & Co” sh.p.k.**

Sot me 10 Maj 2024: Z. Lazër Sallaku, dtl.17 Dhjetor 1962, lindur ne Lezhe, banues ne Lagjja 13, Rr. Kodra Diellit Rezidencat; Nd. 23, H. 44, Ap. 13 Farke, Selite 1045, Tirane identifikuar nëpërmjet kartës se identiteti Nr. G21217033I:

#### **Neni 1**

Emri i shoqërisë është “**Sallaku & Co**” sh.p.k.

#### **Neni 2**

Selia kryesore e shoqërisë do te jete ne Tirane, Rr. Kodra Diellit Rezidencat; Nd. 23, H. 44, Ap. 13, Farke, Selite, Zk. 3292.

#### **Neni 3**

Kohëzgjatja e shoqërisë është për nje periudhe kohe te pacaktuar mbi 10 vjet.

#### **Neni 4**

Administrator i shoqërisë emërohet Z. Lazër Sallaku, dtl. 17 Dhjetor 1962, lindur ne Lezhe, banues ne Lagjja 13, Rr. Kodra Diellit Rezidencat; Nd. 23, H. 44, Ap. 13 Farke, Selite 1045, Tirane identifikuar nëpërmjet kartës se identiteti Nr. G21217033I.

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 100,000 leke.

#### **Neni 6**

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jete:

*“Këshillimit ligjor të personave fizikë dhe juridikë;*

*Përfaqësimit në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;*

*Hartimit të akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;*

*Veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.*

#### **Neni 7**

Shoqëria vepron ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne përputhje me dispozitat e statutit qe i bashkëngjitet këtij akti themelimi.

**THEMELUES**

**LAZËR SALLAKU**

